



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1318/1 prot.

Tiranë, më 14. 10. 2020

**V E N D I M**

**Nr. 139, datë 14. 10. 2020**

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 109, datë 02.10.2020, e shtetases D. L., kundër faqes on-line në rrjetin social Instagram, Stop.al, në të cilën pretendohet diskriminim *për shkak të gjinisë*.

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Rreth 6 vite më parë ankuesja, ka dhënë një intervistë për një nga kompanitë telefonike, që operojnë në vend. Pak kohë më parë, ankuesja është vënë në dijeni se intervista e saj dhe e një grupi vajzash të tjera, po përdorej nga e faqes Stop.al në Instagram, për qëllime fyese dhe degraduese. Në këtë kuptim, ankuesja pretendon se subjekti ndaj të cilit ankohet, po keqpërdor dhe shpërndan videon ku ajo bën pjesë, pa pëlqimin e saj dhe të të intervistuarave të tjera.

Në përfundim të arsyetimit, ankuesja ka kërkuar nga ana e Komisionerit të marrë masa që imazhi i saj në reklamën e kompanisë telefonike, të mos përdoret më nga ana e faqes Stop.al, për qëllime fyese dhe degraduese në mediat sociale.

**II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përrjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Në rastin në fjalë ankuesja ka paraqitur informacion rreth situatës diskriminuese të pretenduar dhe shkakut të diskriminimit nga ana e faqes Stop.al, në rrjetin social *Instagram*.

Në mbështetje të pretendimeve të saj, ankuesja ka vënë në dispozicion të Komisionerit, një link<sup>1</sup> nëpërmjet së cilit mund të evidentohet video për të cilën ankuesja pretendon se përdorej për qëllime fyese dhe diskriminuese. Pas hetimit paraprak, Komisioneri konstatoi se video e pretenduar nga ankuesja dhe faqja Stop.al, në rrjetin social *Instagram*, nuk ishin aktive dhe ishin fshirë nga rrjetet sociale.

Në kushtet që video e përcjellë nëpërmjet linkut nga ankuesja dhe faqja Stop.al, në rrjetin social *Instagram*, janë fshirë, Komisioneri çmon se ka të pamundur vijimin e mëtejshëm të procedurave për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga ana e D. L.

Sa më sipër, Komisioneri me anë të e-mailit datë 05.10.2020 dhe kontaktit telefonik të depozituar në ankuesë, ka provuar të informojë ankuesen lidhur me situatën e sipërcituar, por nuk është bërë e mundur, pasi nuk është kthyer asnjë përgjigje nga ana e saj, si dhe numri i telefonit nuk ishte aktiv.

Bazuar në nenin 33, pika 4, të Ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) është anonime; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta

<sup>1</sup> <https://www.facebook.com/d.....l.../videos/10217564403084795>

*çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt.”*

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, gërma “ç”, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe për rrjedhojë ankesa nuk pranohet.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së shtetas D. L., për shkakun e pretenduar prej saj.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijëni e këtij vendimi.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Gjinia)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)